

DEKLARATË POLITIKE

Lëvizja VETËVENDOSJE! është lëvizje politike e cila synon faktorizimin e popullit në vendimmarrjen politike përmes organizimit dhe përfaqësimit të tij.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për ndryshime rrënjësore shoqërore dhe politike, si dhe për barazinë, lirinë dhe drejtësinë sociale e politike të të gjithëve dhe secilit në Kosovë, pa kurrfarë diskriminimi.

Lëvizja VETËVENDOSJE! synon një Kosovë sovranë, pra, një Kosovë që ka kontroll mbi resurset natyrore, gëzon të drejtën për ushtri të vetën dhe të drejtën për bashkim me Shqipërinë, një Kosovë ku populli është burim i sovranitetit dhe gëzon të drejtën e vetëvendosjes, përmes të cilës, i lirë dhe i papenguar, organizon jetën shoqërore, politike dhe ekonomike në bazë të vullnetit, nevojave dhe interesit të tij.

Visar Ymeri
Kryetar
Lëvizja VETËVENDOSJE!

